



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
DREJTORIA E PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. _____ Prot.

Fier, më ___/ ___/ 2021

Lënda: Formulari i Njoftimit të Fituesit për procedurën me objekt “**Ndërtim i pikës së transferimit të mbetjeve urbane**”, me burim financimi nga Buxheti i Bashkisë Fier

AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK
TIRANË
(për botim)

BASHKIA FIER

Për: Operatorin ekonomik “**VICTORIA INVEST**” shpk

Adresa: Lagjja 28 Nentori, rruga “11 Nentori”, pallati prane Tatim Taksave, kati 2,
Elbasan.

*** * ***

Procedura e prokurimit: **Procedurë e hapur me mjete elektronike.**

Numri i referencës së procedurës / lotit: **REF-84203-01-18-2021.**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “**Ndërtim i pikës së transferimit të mbetjeve urbane**”, me fond limit **19 024 476** (nëntëmbëdhjetë milion e njëzetë e katër mijë e katërqind e shtatëdhjetë e gjashtë) **lekë pa TVSH lekë**, me burim financimi nga Buxheti i Bashkisë Fier, në perputhje me Projektin, Preventivin dhe kushtet e përcaktuara në DST. Afati kohor për ekzekutimin e punimeve: jo më vonë se **6** (gjashtë) **javë**. Objekti do të prokurohet, kontraktohet dhe zbatohet me vlerë të plotë brenda grafikut të punimeve, por financimi do të bëhet në 2 (dy) vite buxhetore (2021, 2022), perkatesisht në shumat 8 000 000 leke me TVSH për vitin 2021 dhe diferenca e mbetur për vitin 2022.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [25 Janar 2021], [Numri 11].

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët- **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “**2 N**” shpk numri i NUIS L31615017L.
Vlera totale sipas formularit te ofertes eshte **14 166 666 lekë pa TVSH.**
2. Operatori ekonomik “**EURO-ALB**” shpk numri i NUIS K66613407H.
Vlera totale sipas formularit te ofertes eshte **15 891 270.68 lekë pa TVSH.**
3. Operatori ekonomik “**VICTORIA INVEST**” shpk numri i NUIS K32712206U.
Vlera totale sipas formularit te ofertes eshte **15 980 560.66 lekë pa TVSH.**
4. Bashkimi i operatorëve ekonomik “**HARMONIA**” shpk numri i NUIS J62903480D & “**SHPRESA - AL**” shpk numri i NUIS K31321021N.
Vlera totale sipas formularit te ofertes eshte **16 017 081.1 lekë pa TVSH.**
5. Bashkimi i operatorëve ekonomik “**ARKONSTUDIO**” shpk numri i NUIS L42019004I & “**VIANTE KONSTRUKSION**” shpk numri i NUIS K47103804L.
Vlera totale sipas formularit te ofertes eshte **13 969 769.96 lekë pa TVSH.**
6. Operatori ekonomik “**NIKA**” shpk, numri i NUIS J76705047U.
Vlera totale sipas formularit te ofertes eshte **13 412 475.87 lekë pa TVSH.**
7. Operatori ekonomik “**ASI-2A CO**” shpk, numri i NUIS K53002402C.
Vlera totale sipas formularit te ofertes eshte **17 686 294 lekë pa TVSH.**
8. Operatori ekonomik “**SARK**” shpk, numri i NUIS K52531415H.
Vlera totale sipas formularit te ofertes eshte **16 709 267 lekë pa TVSH.**
9. Bashkimi i operatorëve ekonomik “**GENERAL BETON**” shpk numri i NUIS K23013401A & “**ED KONSTRUKSION**” shpk numri i NUIS K61625001I.
Vlera totale sipas formularit te ofertes eshte **15 281 332 lekë pa TVSH.**
10. Bashkimi operatorëve ekonomik “**COGREN**” shpk numri i NUIS J74818825K & “**J O G I**” shpk numri i NUIS J63229478K.
Vlera totale sipas formularit te ofertes eshte **16 358 721 lekë pa TVSH.**
11. Operatori ekonomik “**SHENDELLI**” shpk, numri i NUIS K07924803N.
Vlera totale sipas formularit te ofertes eshte **17 160 836 lekë pa TVSH.**

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik “**EURO-ALB**” shpk numri i NUIS K66613407H.
2. Operatori ekonomik “**2 N**” shpk numri i NUIS L31615017L.
3. Operatori ekonomik “**NIKA**” shpk, numri i NUIS J76705047U.
4. Bashkimi i operatorëve ekonomik “**ARKONSTUDIO**” shpk numri i NUIS L42019004I & “**VIANTE KONSTRUKSION**” shpk numri i NUIS K47103804L.
5. Bashkimi i operatorëve ekonomik “**GENERAL BETON**” shpk numri i NUIS K23013401A & “**ED KONSTRUKSION**” shpk numri i NUIS K61625001I.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1.OE “EURO-ALB” shpk ka mangesi ne dokumentacionin e paraqitur per kualifikim, duke mos provuar përvojë të mëparshme të ngjashme, siç percaktohet ne piken 2.3.1, te rubrikes 2.Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Shtojca 12 te DST, per shkak te ketyre mangesive.

Kontrata me Bashkine Shijak me objekt “*Rindertimi i shkolles 9-vjecare Muharrem Dollaku, Shijak*”, eshte lidhur me BOE EURO-ALB shpk dhe Viante Konstruksion shpk, sic dokumentohet ne Formularin e Vleresimit dhe ne kontraten e paraqitur nga subjekti ofertues ne SPE, por ne asnje prej ketyre dokumentave, dhe ne asnje dokument te ofertes, nuk eshte evidentuar apo percaktuar perqindja e ndarjes se punimeve, sic e kerkojne rregullat e prokurimit, ne kuptim edhe te nenit 74 te VKM nr.914 date 29.12.2014 “*Per miratimin e rregullave te prokurimit publik*” i ndryshuar.

Duke u bazuar ne kriteret per kualifikim te DST, ne te cilat per kete pike shprehimisht percaktohet se “*Formulari i vleresimit duhet të përcaktoje saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.*”, vleresohet se mungesa e përqindjes se punimeve në rast bashkimi të shoqërive ne Formularin e Vleresimit sipas shtojces 9 te DST, perbene mangesi ne dokumentacionin e paraqitur dhe si rrjedhoje sjell mos kualifikimin e OE bazuar ne kete dokumentacion.

Kontrata me Kuvendin e Shqiperise me objekt “*Sherbim mirembajtje godine (Lyerje e salles se byrose,.... etj.)*”, me nr.3043/20 date 18.11.2019, si dhe shtesa e kontrates me te njejtin objekt.

Nga shqyrtimi dokumentacionit te kesaj kontrate, rezulton se ajo nuk vleresohet punë e ngjashme, pasi nuk ka elemente te preventivit te ngjashem me objektin e prokurimit, nuk ploteson vleren për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet, gjithashtu rezultojne parregullsi ne dokumentacion pasi punimet, situacioni nuk konfirmohen nga mbikqyres punimesh i licensuar, sic parashikon legjislacioni ne fuqi, nuk ka akt kolaudimi te certifikuar nga kolaudatori i licensuar, sic parashikon legjislacioni ne fuqi, sic kerkohet edhe ne piken 2.3.1, te rubrikes 2.Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Shtojca 12 te DST.

Kontrates se lidhur me Agjencine Kombetare te Mbrojtjes Civile me objekt “*Ndertimi i shtepive te demtuara nga termeti ne Bashkine Durrës*”, i mungon “*Çertifikaten e marrjes në dorëzim*”, sic kerkohet edhe ne piken 2.3.1, te rubrikes 2.Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Shtojca 12 te DST.

OE "EURO-ALB" shpk nuk ka paraqitur dokumentacion te rregullt ne lidhje me kriterin per kualifikim "Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin për vitin 2020, prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit te QKB", te percaktuar ne piken 2.2.3, te rubrikes 2.Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Shtojca 12 te DST.

Bazuar ne kriteret e percaktuara ne DST si dhe ne zbatim të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, referuar kontratave per zbatimin e punimeve te deklaruar nga vet subjekti ofertues EURO-ALB shpk sipas dokumentit "DEKLARATË MBI KONTRATAT E LIDHURA DHE/ OSE NE PROÇES", rezulton se OE ofertues EURO-ALB shpk ka nenshkruar kontrata publike me autoritete kontraktore per pune publike pergjate vitit 2020, per te cilat ne baze te ligjit nr.9920 date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore", neni 3.1/a,b,c dhe neni 40, ne Ligjin nr.131/2015 "Per QKB", si dhe ne Ligjin nr.9723 date 03.05.2007 "Per QKR", mbart detyrimin te hap NIPT dytesor, te deklarohet dhe te regjistrohet ne QKB, si dhe te paraqiste ne kete tender vertetimet per shlyerjen e taksave vendore ne njesite e qeverisjes vendore ne te cilat ka ushtruar apo ushtron aktivitet, konkretisht kontrata me Bashkine Berat e dates 29.06.2020 (e realizuar 80% - EURO-ALB shpk ka 40% te punimeve). Subjekti ofertues EURO-ALB shpk nuk ka paraqitur dokumentacion per shlyerjen e taksave vendore ne Bashkine Berat, ne perputhje me piken 2.2.3, te rubrikes 2.Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Shtojca 12 te DST.

2.Më datë 03.03.2021 ne sistemi elektronik te prokurimeve (SPE) te autoritetit kontraktor Bashkia Fier, eshte paraqitur shkresa e subjektit ofertues 2N shpk, me lëndë "Njoftim për tërheqje" (protokoll nr.417 date 03.03.2021), me anë të së cilës parashtrohet arsyet e tërheqjes nga procedura me objekt prokurimi "**Ndërtim i pikës së transferimit të mbetjeve urbane**".

Duke qënë se një situatë e tillë nuk është e rregulluar nga ligji nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mbështetet në ligji nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i cili në nenin 94, "Tërheqja e kërkesës apo braktisja e procedurës", pika 1 parashikon se "Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë. ".

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se operatori ekonomik pjesëmarrës, është në të drejtën e tij të kërkojë të heqë dorë nga procedura objekt prokurimi dhe për rrjedhojë të mos shqyrtojë dokumentacionin e paraqitur në sistemin elektronik nga ky operatorë ekonomik.

Heqja dorë nga oferta e paraqitur nga operatori ekonomik për procedurën objekt prokurimi sjell për rrjedhojë përfundimin e procedimit administrativ pa një vendim përfundimtar për çështjen.

3.OE "NIKA" shpk nuk ka paraqitur dokumentacion te rregullt ne lidhje me kriterin per kualifikim "Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin për vitin 2020, prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit te QKB", te percaktuar ne piken 2.2.3, te rubrikes 2.Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Shtojca 12 te DST.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit te OE ne SPE per kete tender, NIKA shpk ka paraqitur vertetime per shlyerjen e taksave vendore per vitin 2020 nga Bashkia Prrenjas, Bashkia Maliq, Bashkia Malesia e Madhe, Bashkia Korce, Bashkia Shkoder.

Bazuar ne kriteret e percaktuara ne DST si dhe ne zbatim të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, duke qene se Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e dokumentacionit dhe/ose deklaratave, nga verifikimi ne faqen zyrtare te APP-së ne internet, ne Buletinet e Njoftimeve Publike per vitin 2020, rezulton se OE ofertes NIKA shpk eshte shpallur fitues ose ka nenshkruar kontrata publike me autoritete kontraktore per pune publike ose sherbime publike afatgjata, per te cilat ne baze te ligjit nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore”, neni 3.1/a,b,c dhe neni 40, ne Ligjin nr.131/2015 “Per QKB”, si dhe ne Ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR”, mbart detyrimin te hap NIPT dytesor, te deklarohet dhe te regjistrohet ne QKB, si dhe te paraqiste ne kete tender vertetimet per shlyerjen e taksave vendore ne njesite e qeverisjes vendore ne te cilat ka ushtruar apo ushtron aktivitet.

Bashkia Pukë ka nenshkruar me date 14.01.2020, me BOE NIKA shpk & Sterkaj shpk (perfaqesues me prokurë NIKA shpk), kontraten publike ndertimore me objekt ”Rehabilitimi i Digës Rezervuarit Pukë-Bashkia Puke”, me afat zbatimi 5 muaj. Per kete aktivitet ne Bashkine Puke, OE NIKA shpk nuk e ka deklaruar ne baze te ligjit ne QKB, si dhe nuk ka paraqitur vertetim per shlyerjen e taksave vendore prane Bashkisë Pukë per vitin 2020.

AGJENCIA E BLERJEVE TE PERQENDRUARA ka shpallur fitues NIKA shpk per proceduren me objekt Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me objekt: “Shërbim gatimi dhe shpërndarje e ushqimit për Repartin Special për Kufirin dhe Migracionin “DELTA”, Radhime, Vlore, me fond të përgjithshëm të marrëveshjes kuadër: 21,040,538.4 (njëzetë e një milion e dyzetë mijë e pesëqindë e tridhjetë e tetë pikë katër) lekë pa TVSH, afati 32 (tridhjetë e dy) muaj të lidhjes së Marrëveshjes Kuadër. Per kete aktivitet ne Bashkine Vlore, OE NIKA shpk nuk e ka deklaruar ne baze te ligjit ne QKB, si dhe nuk ka paraqitur vertetim per shlyerjen e taksave vendore prane Bashkisë Vlorë per vitin 2020. Per me teper ne kete rast, referuar DST te kesaj procedure, ne Specifikimet teknike eshte percaktuar se: *“Furnizimi me ujë, energji elektrike dhe gaz të lëngshëm do të kryhet nga vetë operatori ekonomik sipas kontratave që do të lidhe me entet përkatëse furnizuese. Për të garantuar vazhdimësinë e shërbimit është e nevojshme që në rast ndërprerjeje të burimeve të furnizimit të vëre në dispozicion burime alternative furnizimi. Sipërmarrësi që do të kryej këtë shërbim, duhet të lidhë kontratë për energjinë dhe ujin e pijshëm, me institucionet përkatëse (OSHEE dhe Ujësjellësin) duke zbatuar të gjitha rregullat dhe udhëzimet përkatëse.”*Kete detyrim kontraktual, OE NIKA shpk nuk e ka zbatuar dhe nuk e ka reflektuar ne Vertetimin e OSHEE, te cilin ka paraqitur ne tenderin e Bashkise Fier. Ministria e Drejtesise ka shpallur fitues NIKA shpk per proceduren publike me objekt *“Rikonstruksion i Arkivës Shtetërore të Sistemit Gjyqësor”* Fondi limit: 40.934.000 Lekë pa TVSH. Per kete aktivitet ne Bashkine Tirane, OE NIKA shpk nuk e ka deklaruar ne baze te ligjit ne QKB, si dhe nuk ka paraqitur vertetim per shlyerjen e taksave vendore prane Bashkisë Tiranë per vitin 2020. Per me teper, kete kontrate publike, OE Nika shpk e ka deklaruar edhe ne DEKLARATËN MBI KONTRATAT E LIDHURA APO NË PROCËS, te cilen e ka paraqitur ne tenderin e Bashkise Fier. Keshilli i Qarkut Gjirokaster ka nenshkruar me date 29.10.2020, me NIKA shpk, kontraten publike ndertimore me objekt *“Rikonstruksion i ish konviktit të shkollës artistike (kati i parë) dhe përshtatja për Qendrën e Zhvillimit të Fëmijeve”*, me afat zbatimi 13 jave. Per kete aktivitet ne Bashkine Gjirokaster, OE NIKA shpk nuk e ka deklaruar ne baze te ligjit ne QKB, si dhe nuk ka paraqitur vertetim per shlyerjen e taksave vendore prane Bashkisë Gjirokaster per vitin

2020. Nderkohe që në dokumentin PDF të paraqitur në tender për taksat dhe tarifave vendore, OE Nika shpk ka paraqitur Deklaratë me anë të së cilës “*Deklarojmë se Shoqëria ‘NIKA’ Shpk me NIPT J76705047U ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për periudhën vitin 2018, 2019 dhe keqet e maturuara të vitit 2020 sipas afateve të përcaktuara në ligjin 9632/2006 ‘Për sistemin e taksave vendore’, i ndryshuar. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e informacionit të paraqitur. Në rast deklarimi të rreme do të vepohet në përputhje me nenin 13, pika 3, germa ‘a’ të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, ‘Për Prokurimin Publik’.*”, nga verifikimi si me sipër rezultoi se OE Nika shpk nuk ka paraqitur dokumentacion të rregullt, sic përcakton ligji, sa i takon shlyerjes së taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin për vitin **2020**, prandaj njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin.

OE “NIKA” shpk nuk ka paraqitur dokumentacion të rregullt në lidhje me kriterin për kualifikim “*Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund të vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës*”, të përcaktuar në pikën 2.3.8, të rubrikës 2. Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Shtojca 12 të DST.

Në pikën 2.3.8, të rubrikës 2. Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Shtojca 12 të DST, AK ka kërkuar “*Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes deri 10 ton, 2 (dy) cope*”.

OE NIKA shpk për këto pike, ka paraqitur mjetin Kamion me targë SH 6271 E, në pronësi NIKA shpk, të cilit certifikata e kontrollit teknik (SGS) i ka perfunduar në datën 29.12.2020, siguracioni i ka perfunduar në datën 27.10.2020 dhe taksat vjetore janë të vitit 2019, si dhe Kamion me targë AA 328HZ (me qira), certifikata e transportit të mallrave të paraqitur është leshuar për një targë jo të njëjtte me targën e mjetit sipas dokumentacionit të paraqitur në tender. Në këto kushte OE Nika shpk, nuk demonstron kapacitet për disponimin e këtyre mjeteve të kërkuara në DST.

4. Më datë 04.03.2020 në autoritetin kontraktor Bashkia Fier, është protokolluar shkresa e subjektit ofertues BOE ARKONSTUDIO shpk & VIANTE KONSTRUKSION shpk, me lëndë “*Njoftim për heqje dorë*” (protokolluar me nr.2066 datë 04.03.2021), me anë të së cilës parashtron arsyet e tërheqjes nga procedura me objekt prokurimi “**Ndërtim i pikës së transferimit të mbetjeve urbane**”.

Duke qënë se një situatë e tillë nuk është e rregulluar nga ligji nr.9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mbështetet në ligji nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”, i cili në nenin 94, “*Tërheqja e kërkesës apo braktisja e procedurës*”, pika 1 parashikon se “*Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë.*”.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se operatori ekonomik pjesëmarrës, është në të drejtën e tij të kërkojë të heqë dorë nga procedura objekt prokurimi dhe për rrjedhojë të mos shqyrtojë dokumentacionin e paraqitur në sistemin elektronik nga ky operator ekonomik. Heqja dorë nga oferta e paraqitur nga operatori ekonomik për procedurën objekt prokurimi sjell për rrjedhojë përfundimin e procedimit administrativ pa një vendim përfundimtar për çështjen.

5.Më datë 04.03.2020 ne autoritetin kontraktor Bashkia Fier, është protokolluar shkresa e subjektit ofertues BOE GENERAL BETON shpk & ED KONSTRUKSION shpk, me lëndë "Kërkesë tërheqje" (protokoll nr.2032 date 04.03.2021), me anë të së cilës parashtron arsyet e tërheqjes nga procedura me objekt prokurimi "Ndërtim i pikës së transferimit të mbetjeve urbane".

Duke qënë se një situatë e tillë nuk është e rregulluar nga ligji nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mbështetet në ligji nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i cili në nenin 94, "Tërheqja e kërkesës apo braktisja e procedurës", pika 1 parashikon se "Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë. ".

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se operatori ekonomik pjesëmarrës, është në të drejtën e tij të kërkojë të heqë dorë nga procedura objekt prokurimi dhe për rrjedhojë të mos shqyrtojë dokumentacionin e paraqitur në sistemin elektronik nga ky operatorë ekonomik.

Heqja dorë nga oferta e paraqitur nga operatori ekonomik për procedurën objekt prokurimi sjell për rrjedhojë përfundimin e procedimit administrativ pa një vendim përfundimtar për çështjen.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik "**VICTORIA INVEST**" shpk numri i NUIS K32712206U, Adresa: *Lagjja 28 Nentori, rruga "11 Nentori", pallati prane Tatim Taksave, kati 2, Elbasan*, se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej **15 980 560.66 lekë pa TVSH**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Njësisë së Prokurimit të Bashkisë Fier, Lagjja "Kastriot", Rruga "Ramiz Aranitasi"**, sigurimin e kontratës dhe të nëshkruani kontratën, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **05.03.2021**.

Ankesa: ka ose jo,- **JO**.

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë:

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Armando SUBASHI